



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo


Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë

Ministarstvo Trgovine i Industrije - Ministry of Trade and Industry

Departamenti i Turizmit / Department Turizma / Department of Tourism

Raport analitik për sektorin akomodimit në Republikën e Kosovës



Dhjetor 2018

Përmbajtja

Hyrje	3
Metodologjia	4
1. Kapacitetet akomoduese në Kosovë	5
1.1 Kapacitet akomoduese sipas komunave.....	6
1.2 Top 10 komunat me më së shumti struktura akomoduese	7
1.3 Numri i të punësuarve në strukturat akomoduese	8
2. Numri i dhomave, çmimeve dhe niveli i shfrytëzimit.....	9
3. Përbërja e musafirëve.....	11
4. Qarkullimet dhe investimet.....	12
5. Shërbimet e ofruara.....	13
5.1. Shërbimet e kryesore të ofruara nëpër hotele	13
6. Pengesat e të bërit biznes	14
7. Zonat / Destinacionet sipas operimit nga tour operatorët në Kosovë	15
8. Produktet turistike më të kërkuara nga turistët	17
9. Vizitorët në Kosovë sipas rajoneve.....	17
10. Konkluzionet dhe rekomandimet	19

Hyrje

Sektori i akomodimit përbën një nga komponentët kryesor për zhvillimin e një destinacioni turistik, andaj vëmendje e veçantë i kushtohet këtij komponenti krahas komponentëve tjera që janë gjithashtu të nevojshme dhe kyç.

Ky raport përfshin një analizë të gjendjes në tërë territorin e Kosovës, lidhur me kapacitetet akomoduese ku paraqitet madhësia e sektorit të akomodimit në Kosovë sa i takon numrit të strukturave akomoduese dhe shtretërve si dhe dhomave sipas strukturave akomoduese që veprojnë në Kosovë dhe ushtrojnë veprimtarinë aktive. Gjithashtu raporti paraqet prezencën e strukturave akomoduese në bazë të destinacioneve turistike, përkatësisht tenton të paraqet një pasqyrë për lexuesin se në cilat zona të Kosovës mungon akomodimi dhe në cilat zona ka nevojë për zgjerimin apo investime të reja në sektorin e akomodimit.

Analiza është e fokusuar veçanërisht në sektorin privat duke qenë se shumica e strukturave akomoduese në Kosovë kanë pronësi private. Ndër tjerash janë analizuar edhe llojet e strukturave akomoduese që mungojnë apo janë të pakta. Gjithashtu paraqiten shërbimet brenda sektorit të akomodimit që ofrohen. Ndër tjerash prezantohet edhe niveli i shfrytëzueshmërisë së dhomave brenda vitit si dhe është tentuar të jepet edhe një pasqyrë rreth çmimeve për dhoma.

Të gjeturat nga analiza do të mund t'u shërbej investitorëve të huaj direkt apo investitorëve vendor në sektorin e akomodimit. Prandaj ky raport ka për qëllim kryesor të shërbej si një bazë premtuese për investitorët dhe kompanitë potenciale në sektorin e akomodimit, duke pasqyruar nevojat për hapjen e njësive të reja të akomodimit.

Metodologjia

Qasja e hartimit të raportit për sektorin e akomodimit në Kosovë, i takon asaj përshkruese dhe analitike.

Ky raport bazohet në të dhënat e mbledhura nga institucionet përgjegjëse për statistika turistike dhe hoteliere, përkatësisht nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) dhe Policia Kufitare. Për kapacitetet akomoduese është përdorur databaza e realizuar përmes ASK-së e cila ka rezultuar nga një anketë e zhvilluar në teren me të gjitha strukturat akomoduese ekzistuese në Kosovë. Në këtë hulumtim janë përdorur edhe nga raportet e realizuara nga projekti Promoting Private Sector Employment (PPSE) në kuadër të Swisscontact që vepron në Kosovë si dhe raportet e dokumentet tjera që ndërlidhen me sektorin e akomodimit apo me sektorin e turizmit në përgjithësi.

Një pjesë dominante e të dhënave janë bazuar nga një anketë e zhvilluar me palët e involvuara në sektorin e akomodimit dhe turizmit, përkatësisht me përfaqësuesit e bizneseve akomoduese dhe hoteliere e realizuar nga PPSE/Swisscontact.

Përpunimi, paraqitja grafike dhe analizimi i të dhënave është bërë nga Departamenti i Turizmit, në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

1. Kapacitetet akomoduese në Kosovë

Sipas të dhënave nga ASK, në bazë të regjistrimit të kapaciteteve të akomodimit në Kosovë, të dhënat e përpunuara nga Departamenti i Turizmit, rezulton se gjithsej kemi 465 struktura akomoduese aktive.




Figura 1: Paraqitja grafike për kapacitetet e akomodimit në Kosovë¹

Nga 198 hotele aktive ka më shumë se 4,300 dhoma dhe rreth 7,000 shtretër, të pasuar nga rreth 182 motele me mbi 2,150 dhoma dhe rreth 2,900 shtretër.

¹ Burimi: Përpilim vetanak (përshtatur nga ASK, 2016)

1.1 Kapacitet akomoduese sipas komunave

Në tabelë shihet se numri më i madh i strukturave akomoduese gjendet në komunën e Prishtinës, pastaj radhitet Peja, Prizreni, Ferizaj, e kështu me radhë. Kategoritë kryesore të njësive akomoduese në Kosovë janë hotelet dhe motelet.

	Komuna	Hotel	Motel	Bujtinë	Bunga llou	Hapësirë për kamping, parqe rekreative për automjete dhe parqe për kamp-shtëpiza	Hostel	Apartam ente për vizitorë	Totali i struktura rave akom.
1	Deçan	3							3
2	Dragash	2							2
3	Drenas	5	2						7
4	Ferizaj	4	33	4					41
5	Fushë Kosovë	13	9						22
6	Gjakovë	12	2		1				15
7	Gjilan	11	10		1				22
8	Graçanicë	4	8		1				13
9	Han i Elezit		1						1
10	Istog	7	6						13
11	Junik	1	1						2
12	Kaçanik	1	3	1					5
13	Kamenicë	1	1						2
14	Klinë	4	8			6			18
15	Lipjan	2	10		1				13
16	Malishevë	1	3						4
17	Mitrovicë	6	7						13
18	Novo Bërd		2		1				3
19	Obiliq	4	3						7
20	Pejë	20	9		29	11			69
21	Podujevë	3	1						4
22	Prishtinë	42	14	2			6	14	78
23	Prizren	34	12	1	3		3	1	54
24	Rahovec	3	6						9
25	Ranillug		1						1
26	Shtërpçë	2	7		1				10
27	Shtime		5						5
28	Skenderaj	1	2						3
29	Suharekë	6	4	1					11
30	Vitija	2	4						6
31	Vushtrri	2	2						4
32	Zubin Potok	1	1						2
33	Zveçan	1	2						3
	Total	198	179	9	38	17	9	15	465

Tabela 1. Numri i strukturave akomoduese sipas komunave dhe llojit

Hotelet përfshijnë 42% të totalit të njësive akomoduese, ndërsa motelet 39%. Në pjesën tjetër, 19%, janë të përfshira kategoritë e tjera të strukturave akomoduese, më të vogla në Kosovë, si: bujtinat, hostelet, apartamentet për vizitorë, bungallotë dhe hapësirat për kamping, të cilat janë në zhvillim e sipër.

1.2 Top 10 komunat me më së shumti struktura akomoduese

Sa i përket kapaciteteve akomoduese, Prishtina udhëheq në aspektin e njësive, dhomave dhe kapacitetit të shtretërve, e pasuar nga Prizreni dhe Peja.




Figura 2. Qytetet me numër më të lartë të kapaciteteve akomoduese²

² Burimi: Përpilim vetanak (përshtatur nga ASK, 2016)

1.3 Numri i të punësuarve në strukturat akomoduese

Të punësuar në strukturat e akomodimit gjithsejtë janë 2.701 sipas kapaciteteve të regjistruara, në kuadër të 465 struktura akomoduese. Prej tyre kemi 638 femra të punësuar në total në raport me të punësuarit meshkuj ose në përqindje kemi rreth 24 % femra.

Nr.	Komuna	Kapacitetet akomoduese	Numri i të punësuarve	
		Struktura akomoduese	Gjithsej	Prej tyre femra
1	Deçan	3	10	-
2	Dragash	2	32	9
3	Drenas	7	23	-
4	Ferizaj	41	95	6
5	Fushë Kosovë	22	124	28
6	Gjakovë	15	77	2
7	Gjilan	22	137	28
8	Graçanicë	13	100	22
9	Istog	13	112	41
10	Junik	2	9	-
11	Kaçanik	5	21	1
12	Kamenicë	2	15	4
13	Klinë	18	45	6
14	Lipjan	13	41	3
15	Malishevë	4	13	1
16	Mitrovicë	13	79	11
17	Obiliq	7	52	9
18	Pejë	69	214	65
19	Podujevë	4	24	8
20	Prishtinë	78	920	305
21	Prizren	54	305	67
22	Rahovec	9	49	1
23	Shtërpçë	10	32	2
24	Skenderaj	3	7	-
25	Suharekë	11	58	4
26	Viti	6	17	1
27	Vushtrri	4	64	9
28	Zubin Potok	2	15	3
29	Zveçan	3	11	2
Totali		465	2.701	638

Tabela 2. Numri i të punësuarve sipas kapaciteteve të strukturave akomoduese




Figura 3. Paraqitja grafike e të punësuarve në strukturat akomoduese sipas komunave

Sipas figurës shihet se komuna me më së shumti të punësuar në struktura akomoduese është komuna e Prishtinës me 920, pastaj vijon komuna e Prizrenit me 305, Peja me 214, kemi Gjilanin me 137, duke vijuar edhe me Fushë Kosovën që ka 124 dhe Istogu me 112 të punësuar në strukturat akomoduese.

Ndërsa komunat me më pak të punësuar në strukturat akomoduese janë siç vijon: Skenderaj 7, Juniku 9, Deçani 10, Zveçan 11, Zubin Potok dhe Kamenica me nga 15 të punësuar në strukturat akomoduese.

2. Numri i dhomave, çmimeve dhe niveli i shfrytëzimit

Sipas të dhënave nga projekti PPSE/Swisscontact, numri mesatar i dhomave njëshe standarde në akomodim me restorante është 10.9. Për dhoma dyshe standarde, mesatarja është pak më e lartë - 13.2. Numri i përgjithshëm i dhomave njëshe standarde arrin në 1,149, ndërsa numri i përgjithshëm i dhomave dyshe standarde arrin 1,671. Çmimi mesatar për një dhomë njëshe standarde është 40.1 EUR, ndërsa për një dhomë dyshe është 45.8 EUR. Kur llogaritet nga numri i dhomave në dispozicion, çmimi mesatar i një dhomë njëshe dhe dyshe standarde rezulton të jetë respektivisht 50.1 dhe 69.4 euro. Ky ndryshim ndodh për shkak të dominimit të hoteleve me numër përgjithësisht të madh të dhomave dhe çmime më të larta. Për më tepër, gjetjet tregojnë se vetëm 29.9 për qind e të gjitha akomodimeve me restorante kanë rritje të çmimeve të tyre gjatë kulmit të sezonës, ndërsa pjesa tjetër i mbajnë çmimet e pandryshuara. Nga të gjitha kategoritë, siç pritet, hotelet kanë çmimin mesatar më të lartë për të dyja dhomat si njëshe (42.3 euro) dhe dyshe (49.4 euro).

Dhoma njëshe standarde	Mesatare # e dhomave	10.9
	Çmimi mesatar (EUR)	40.1
	Totali # i dhomave	1,149
Dhoma dyshe standarde	Mesatare # e dhomave	13.2
	Çmimi mesatar (EUR)	45.8
	Totali # i dhomave	1,671
Dhoma treshe standarde	Mesatare # e dhomave	6.0
	Çmimi mesatar (EUR)	53.1
	Totali # i dhomave	623
Dhoma katërshe standarde	Mesatar # e dhomave	8.9
	Çmimi mesatar (EUR)	49.5
	Totali # i dhomave	224

Tabela Nr.3. Akomodimet me restorante – Numri mesatar dhe çmimi i dhomave standarde (2017)

Sipas të gjeturave nga kjo anketë në një zbërthim nga top tri rajonet vërehet se Prishtina ka numrin / mesataren më të lartë të dhomave njëshe dhe dyshe, si dhe çmimet mesatare më të larta.

		Tërë vendi	Rajoni i Prishtinës	Rajoni i Pejës	Rajoni i Prizrenit
Dhoma njëshe standarde	Mesatare # e dhomave	10.9	17.1	11.6	6.9
	Çmimi mesatar (EUR)	40.1	50.2	35.6	34.4
	Totali # i dhomave	1,149	494	218	70
Dhoma dyshe standarde	Mesatare # e dhomave	13.2	20.6	15	7.4
	Çmimi mesatar (EUR)	45.8	60.8	42	36.2
	Totali # i dhomave	1,671	768	320	145

Tabela Nr. 4. Akomodimet me restorante – Numri mesatar dhe çmimi i dhomave standarde, sipas tri top rajonet (2017)

Niveli vjetor i shfrytëzimit është mesatarisht në 42.6 për qind, duke ndryshuar nga 33.3 për qind në shkurt në 61.8 për qind në gusht. Nga tre top rajonet, rajoni i Pejës rezulton të ketë normën më të lartë të shfrytëzimit³. Për të parë luhatjet në baza mujore, ju lutem shihni figurën

³ PPSE, Swisscontact, KOSOVO TOURISM SUPPLY SIDE SURVEY 2017




Figura 4. Akomodimet me restorante- niveli i shfrytëzimit në 2017, sipas muajve (në përqindje)

3. Përbërja e mysafirëve

Gjithashtu është hulumtuar edhe përbërja e mysafirëve si dhe kohëzgjatja e qëndrimit të tyre. Nga kjo anketë vërehet se, sa i përket origjinës, ndërkombëtarët përbëjnë rreth gjysmën e mysafirëve të përgjithshëm - 50.6 përqind; diaspora, 22.7 për qind; vizitorët vendas (me më shumë se 20 minuta të udhëtimit), 14.9 përqind; dhe vizitorë vendas (më pak se 20 minuta udhëtimesh), 11.8 përqind. Qëndrimi i tyre mesatar është 3.2 netë.




Figura 5. Akomodimet me restorante – përbërja e mysafirëve në 2017, sipas origjinës

Restorantet e këtyre strukturave të akomodimeve presin mesatarisht 90.3 mysafirë në ditë. Gushti duket të jetë muaji më i gjallë, me një mesatare prej 125.5 vizitorësh në ditë. Një tjetër gjetje tregon se 55.4 përqind e mysafirëve vijnë për ushqim dhe pije dhe shpenzojnë mesatarisht 8.5 euro; ndërsa 44.6 përqind vijnë vetëm për pije dhe mesatarisht shpenzojnë 3.7 euro.




Figura 6. Numri mester i mysafirëve në restorantet e akomodimeve, sipas muajve (2017)

4. Qarkullimet dhe investimet

Sa i përket qarkullimit, pothuajse gjysma e akomodimeve me restorante - 49.4 për qind – kanë përfomuar 'më mirë' ose 'shumë më mirë' krahasuar me vitin 2016; ndërsa 6.2 për qind kanë përjetuar të kundërtën; pjesa tjetër (44.4 përqind) nuk ka përjetuar asnjë ndryshim (si në figurën vijuese). Ekziston një shpërndarje shumë e ngjashme e përgjigjeve në pyetjen rreth qarkullimit të pritur për vitin 2018.




Figura 7. Akomodimet me restorante – qarkullimet krahasuar me 2016 (në %)




Figura 8. Akomodimet me restorante – qarkullimet e pritura në 2018 (në %)

5. Shërbimet e ofruara

Në pyetjen lidhur me shërbimet e ofruara, përgjigjet më të shpeshta ishin: shërbimet e lavanderisë (70.5 përqind të rasteve), shërbime për udhëzues/ciceronë (66.7 përqind) dhe shërbimet e transportit (43.6 përqind). Për llojet e tjera të shërbimeve të ofruara nga akomodimet me restorante, shih figurën 6. Vlen të përmendet se më shumë se një e treta e tyre - 35.6 përqind - ofrojnë hapësirë për dasma dhe ahengje të tjera familjare.

5.1. Shërbimet e kryesore të ofruara nëpër hotele




Figura 9. Akomodimet me restorante - shërbimet e ofruara (në % të rasteve)

Shërbimet e ofruara nga hotelet sipas ASK-së

Ndërsa sipas ASK-së, janë hulumtuar shërbimet e ofruara nga hotelet si në figurën e më poshtme. Ku vërehet se shumica e hoteleve ofrojnë shërbimet bazike të një hoteli. 94% e tyre ofrojnë shërbime të internetit/WIFI, ndërsa 93 % e tyre ofrojnë parking të mjaftueshëm, ajër i kondicionuar 88 % e tyre , ndërsa 83 % e tyre ofrojnë restorant brenda strukturave të tyre. Shumë pak prej tyre ofrojnë shërbimet e kazinove, salle për lojëra ku kemi rreth 1 %, ndërsa 7 % e hoteleve në Kosovë ofrojnë shërbime për trajtime estetike.

Pjesëmarrja e hoteleve te cilat ofrojnë shërbime:	(në %)
Restaurant	83%
Pishinë	13%
Sallë dasmash	52%
Sallë takimesh	57%
Sallë fitnesi	15%
Dhoma për trajtime estetike	7%
Kënd lojërash për fëmijë	28%
Shitore me suvenire, gazeta, etj.	8%
Kazino, sallë për lojëra	1%
Internet/WIFI	94%
Ajër i kondicioner	88%
Parking	3%
Shërbim në dhomë	80%

Tabela 5. Shërbimet e ofruara nga hotelet sipas ASK

6. Pengesat e të bërit biznes

Akomodimet janë pyetur gjithashtu për të zgjedhur pengesat më shtrënguese për të bërë biznes. 'Promovimi i ulët i rajonit' (61.6 përqind e të gjitha rasteve), 'përpjekjet e ulëta të qeverisë' (55.8 përqind) dhe 'infrastruktura rrugore' (50 përqind) perceptohen si pengesat më shtrënguese operative sipas akomodimeve, shih figurën 24).



Fig. 10. Akomodimet me restaurante – pengesat e të bërit biznes në vitin 2017 (në % të rasteve)

7. Zonat / Destinacionet sipas operimit nga tour operatorët në Kosovë

Sipas një databazë që posedon Departamenti i Turizmit për Tour Operatorët që ofrojnë oferta turistike për ta vizituar Kosovën shihet se kemi 28 operator turistik. Nga tabela e më poshtme 22 prej tyre janë Inbound Tour Operator dhe 6 prej tyre janë Inbound/Outbound Tour Operator. Të shpërndarë sipas lokacioneve më së shumti ka nga qyteti i Prishtinës, pasuar nga Peja dhe Prizreni me nga 5 tour operator.

Nga të dhënat shihet se vetëm në qytetin e Prishtinës operojnë Inbound/Outbound Tour Operator.

Destinacioni kryesor	Inbound Tour Operator	Inbound/Outbound Tour Operator	Total
Brezovica	1		1
Gjeravica	1		1
Junik	1		1
Kosovo	6	6	12
Prishtina, Prizren	2		2
Prishtinë	1		1
Prizren	4		4
Rugova	5		5
Western Kosovo	1		1
Total	22	6	28

Tabela 6. Tour Operatorët që ofrojnë oferta në ardhje (Inbound) sipas destinacioneve që operojnë

Në tabelën nr. 6 janë paraqitur Tour Operatorët që operojnë oferta turistike në ardhje për Kosovë. Disa prej tyre operojnë edhe në dalje, por nuk janë përfshirë Operatorët që ofrojnë oferta vetëm në dalje nga Kosova (Outbund).

Sipas përfshirje së destinacioneve të operimit, vërehet se 6 prej tyre operojnë oferta në ardhje (Inbound) dhe 6 prej tyre operojnë oferta në ardhje dhe dalje (Inbound dhe Outbound) në tërë territorin e Kosovës.

5 prej Tour Operatorëve që operojnë oferta turistike në ardhje operojnë në destinacionin e Rugovës, ndërsa kemi 4 Tour Operatorë që operojnë oferta turistike në ardhje në destinacionin e Prizrenit.




Figura 11. Parqitja grafike për Tour Operatorët që ofrojnë oferta në ardhje (Inbound) sipas destinacioneve që operojnë

Turnetë dhe çmimet

Të gjeturat ilustrojnë se 56.5 përqind e operatorëve turistikë punojnë me turistë që vijnë dhe ata që shkojnë, ndërsa 43.5 përqind vetëm me turistë që vijnë. Numri i përgjithshëm i turneve/udhëtimeve të shitura është 525 turne, mesatarisht me 17.4 njerëz për turne. Çmimi mesatar arrin në 299.4 euro.

Punësimi

Pothuajse dy të tretat e të gjithë punëtorëve (59.2 përqind) që punojnë për operatorët turistikë janë meshkuj. Vetëm gjysma e tyre punojnë me orar të plotë. Komunitetet jo-shumicë përbëjnë 93.3 përqind të të gjithë punëtorëve. Ato/ata ndërmjet moshës 15 dhe 34 vjeç përbëjnë shumicën e punëtorëve me 71.3 përqind. Për më shumë informata, shih tabelën 9.

Punësimi demografik (Tour Operators)						
Gjinia	Meshkuj			Femra		
	59.2%			40.8%		
Plot vs gjysm Orari	Me orarë të plot (Men)		Gjysmë orari (Men)	Orarë të plotë (Femra)		Gjysmë orari (Femra)
	23.7%		35.5%	26.0%		14.8%
Etniciteti	Shqiptar	Serb	Turq	RAE	Boshnjak	Tjerë
	96.7%	0.0%	0.8%	0.8%	0.0%	1.7%
Grupmosha	15-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65<
	18.9%	52.4%	24.4%	3.7%	0.6%	0.0%

Tabela Nr.7. Punësimi demografik (Operatorët e turneve)

8. Produktet turistike më të kërkuara nga turistët

Nga intervistimet e bëra me operatorët turistik, realizuar nga PPSE për produktet më të kërkuara nga turistët, rezulton se produktet më të kërkuara nga turistët janë:

Peaks of Balkan	Bike tours
Etnokultura	Toure kulturore
Dare adventure	Vizitë Dukagjinit
Ture Regjionale	Horse riding
Climbing	Wine testing
Hiking and Yoga	Discover Kosovo
Ture Kosove-Shqipëri-Maqedoni	Via Ferata
Malet e Sharrit	Kosovo culture tour
Vizitë qytetit Prizrenit	Ture Kosove-Shqipëri
Gjeravica	Prizreni
Hiking tour	Cycling
Via Dinarica	Zipline
Cave hiking	Snowshoeing
Vizitë qytetit të Prishtinës	Vizitë qyteteve

Tablea 8. Produktet më të kërkuara nga turistët

9. Vizitorët në Kosovë sipas rajoneve

Numri i vizitorëve ndërkombëtarë dhe netëve të shpenzuara gjatë periudhës së dhënë në grafik tregon një rritje konsistente gjatë viteve duke arritur numrin më të lartë (86 mijë vizitorë dhe 144 mijë netë të shpenzuara) në vitin 2017.




Figura Nr.12. i vizitorëve sipas rajoneve⁴

⁴ Burimi: Përpilim vetanak (përshtatur nga ASK, 2018)

Siç shihet në figurë, rajoni i Prishtinës ka hisen më të madhe të tregut duke arritur kulmin në vitin 2015 me mbi 89,000 vizitorë në vit, pasuar nga Peja dhe Prizreni. Prizreni dhe Ferizaj kanë normën më të lartë të përbërë të rritjes vjetore, ndërsa Gjilani ka normë negative të përbërë të rritjes vjetore.




Figura Nr.13. Numri i netëve të shpenzuara sipas rajoneve⁵

Për sa i përket netëve të shpenzuara sipas rajonit, Prishtina ka hisen më të madhe të tregut gjatë gjithë periudhës, e ndjekur sërish nga Peja dhe Prizreni me një rritje të konsiderueshme të regjistruar gjatë viteve 2014 – 2015.




Figura Nr.14. Hiset në treg sipas rajoneve (nr. i vizitorëve)

Hisja e tregut për vitin 2017, dominohet nga Prishtina me rreth 60%, dhe ngjashëm me vitet e kaluara është ndjekur përsëri nga qyteti i Prizrenit (15%) dhe Peja (13%). Pjesa tjetër e rajonit ka vetëm 12% të hises së tregut e cila është mjaft e ulët krahasuar me tri të parat; prandaj, duhet të shikojmë se si të rritet hisja e tregut për pjesën tjetër të rajonit, në mënyrë që të kemi një shpërndarje më të barabartë të vizitorëve.

⁵ Burimi: Përpilim vetanak (përshtatur nga ASK, 2018)

10. Konkluzionet dhe rekomandimet

Nga analiza e bërë rreth gjendjes së zhvillimit të sektorit të akomodimit në Kosovë, për rastin në studim (rasti i Kosovës), janë vlerësuar me interes turistik dhe janë analizuar aspektet e akomodimit në Kosove me perspektivën që pritet ta shoqëroj zhvillimin e tij në të ardhmen dhe me reflektim të rëndësishëm edhe rajonal.

Një destinacion turistik i zhvilluar konsiderohet vendi i cili ka të zhvilluara komponentët kryesor ku përveç atraksioneve, nevojiten edhe komponentët tjerë si akomodimet, aktivitetet, qasja e mirë, elementët përcjellëse etj. Në këtë raport u analizua një nga komponentët kryesor siç është akomodimi.

Pasi që hotelet dhe motelet përfaqësojnë shumicën dërmuese (rreth 80 % të totalit) të strukturave akomoduese dhe ekzistojnë shumë pak struktura tjera, vërehet se nevoja është shumë e madhe për ngritjen e strukturave tjera si: Hostele, apartamente, bungallo, hapsira kampingjesh e të tjera të ngjashme. Kjo ndërlidhet edhe me faktin se produktet turistike më të zhvilluara me të cilat konkurron Kosova duhet të përshtateshin shumë mirë me këto lloj strukturash akomoduese, për shembull ofertat turistike të llojit të turizmit aktiv, avanturistik, turizmit rural etj.

Nga kjo analizë vërehet se pjesa më e madhe e hoteleve gjenden në Rajonin e Prishtinës, Pejës, Prizrenit, pastaj vijojnë komunat tjera.

Nëse listojmë komunat sipas përfshirjes së potencialeve më të madha turistike brenda hapësirave të tyre, do të kemi këto komuna : Peja, Prizreni, Shtërpca, Dragashi, Deçani, Juniku, Gjakova, Prishtina, Novobërda, Mitrovica, Zubin Potoku, Zveçan , Rahovec dhe Graçanicë. Ndërsa nga analizat u pa që disa komuna me potencial turistik nuk gjenden në top 10 komunat sipas kapaciteteve akomoduese. Këtu mund të përmendim komunën e Deçanit (gjithsej 3 struktura), Dragash (2), Junik (2), Mitrovicë (13), Novobërde (3), Rahovec (9), Shtërpce (10), Zubin Potok (2), dhe Zveçan (3).

Sa i takon punësimit në strukturat e akomodimit gjithsejtë në kuadër të 465 struktura akomoduese, kishim vetëm 24 % femra të punësuar. Në sektorin e akomodimit mund të punësohen më shumë femra pasi që përvojat në vendet ndërkombëtare kanë treguar se femrat kanë qenë shumë të suksesshme në sektorin e akomodimit dhe përqindja e punësimit është shumë e madhe. Sipas statistikave nga Eurostat, fuqia punëtore e industrive të turizmit përfshin më shumë punëtorë femra (58%) sesa punëtorët meshkuj. Përqindjet më të larta shihen në akomodim (60%)⁶.

⁶ https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php/Tourism_industries_-_employment#Tourism_creates_jobs_for_women

Pasi që shfrytëzimi i dhomave u pa që është në nivel jo të kënaqshëm, rekomandohet që operatorët hotelier të bashkëpunojnë më shumë me operatorët turistik (Tour Operatorët dhe Agjencitë Turistike) për të shitur ofertat turistike dhe që të rritet edhe niveli i shfrytëzimit të dhomave në strukturat e tyre akomoduese. Operatorët turistik do të përfshijnë akomodimin brenda paketave të tyre turistike dhe kjo kërkon një bashkëpunim të dy anëshëm si nga sektori i akomodimit dhe nga sektori i operimeve.

Duke qenë se vendet e rajonit sidomos turistët nga Shqipëria janë dukshëm në rritje gjë që duhet të mendohet për rritjen e kapaciteteve edhe sidomos në qendrat më afër kufirit siç është Prizren etj.

Nga hulumtimet e fundit shihet se kapacitetet akomoduese nuk mjaftojnë edhe nuk përkojnë me realitetin kur dihet se kemi rritje të vazhdueshme të numrit të turistëve.